

**Njoftim për përqendrimin me të cilin GEN-I SONCE, shërbime energjetike, sh.p.k.,
Slloveni fiton kontroll të vetëm mbi FV PLANT 2, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar,
Beograd-Vračar, Republika e Serbisë**

(lënda nr. 08-165/ 2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 20.11.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim, me të cilin GEN-I SONCE, shërbime energjetike, sh.p.k., me seli të regjistruar në Dunajska cesta 119, 1000 Lubjanë, Slloveni, do të fitojë kontroll të vetëm mbi FV PLANT 2 shoqëri me përgjegjësi të kufizuar Beograd-Vračar, me seli të regjistruar në Juzhni bulevar 101, 11000 Beograd, Serbi, nëpërmjet shitblerjes së pjesëve.

-GEN-I SONCE, shërbime energjetike, sh.p.k. është pjesë e grupit të kompanive GEN-I ("GEN-I Grup"). GEN-I Grup, i cili përbëhet nga GEN-I, tregti dhe shitje e energjisë elektrike, sh.p.k. (*GEN-I, trgovanje in prodaja električne energije, d.o.o.*) dhe 24 subjektet e tij të kontrolluara, është një nga lojtarët me rritjen më të shpejtë dhe më inovativë në tregun energjetik evropian. Grupi operon në më shumë se 20 tregje evropiane, nga Franca në perëndim deri në Turqi në lindje.

Aktivitetet ndërkombëtare menaxhohen nga Sllovenia, ku shoqëritë e varura janë të pajisura me të gjithë infrastrukturën e nevojshme për pjesëmarrje në tregjet lokale dhe ndërkombëtare të energjisë. Për këtë arsye, GEN-I Grup ruan rolin e tij udhëheqës si tregtar rajonal në tregun e energjisë, si dhe furnizues kryesor dhe promovues i transformimit të gjelbër në Slloveni.

GEN-I Grup ka tre shoqëri të varura në Maqedoninë e Veriut:

- **GEN-I Kav Sonce SHPKNJP Shkup**, me seli në Bulevardin Partizanski Odredi nr. 15 A/1 Shkup – Qendër, NJA 7607172, me veprimtari të regjistruar – prodhimi i energjisë elektrike nga burime të rinovueshme;
- **GEN-I Shitje e energjisë SHPKNJP Shkup**, me seli në Bulevardin Partizanski Odredi nr. 15 A/1 Shkup – Qendër, me veprimtari të regjistruar – tregti me energji elektrike; dhe
- **GEN-I Sonce SHPKNJP Shkup**, me seli në Bulevardin Partizanski Odredi nr. 15 A/1 Shkup – Qendër, me veprimtari të regjistruar – prodhimi i energjisë elektrike nga burime të rinovueshme.

-FV PLANT 2 shoqëri me përgjegjësi të kufizuar Beograd-Vračar është investitor (mbajtës i projektit) në ndërtimin e dy centraleve diellore në Serbi, të vendosura në Baçinci, Komuna e Shidit, Vojvodinë: CD Baçinci 1 dhe CD Baçinci 2. FV PLANT 2 shoqëri me përgjegjësi të kufizuar Beograd-Vračar planifikon të ndërtojë, mirëmbajë dhe menaxhojë centralet fotovoltaike CD Baçinci 1 dhe CD Baçinci 2.

FV PLANT 2 shoqëri me përgjegjësi të kufizuar Beograd-Vračar nuk ka prani korporative në Maqedoninë e Veriut dhe as nuk gjeneron qarkullim në Maqedoninë e Veriut.

Tregu përkatës

Transaksioni i propozuar ka të bëjë me tregun për prodhimin dhe shitjen me shumicë të energjisë elektrike.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni ka konstatuar se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara që të dorëzojnë vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim pranë Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: Rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, Shkup ose përmes e-mailit: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision në afat prej 10 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

21.11.2025

Shkup